



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:130195

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06347180

P.nr.134/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona LAJQI, më bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të pandehurit N. V., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.1965/202, të dt.30.07.2021. Duke vepruar sipas propozimit të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës me tutje me shkurtesën (IPFK-së), për ndërprerjen e masës: Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim, me propozimin që ndaj të pandehurit N. V., të shqiptohet Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri. Pas mbajtjes së seancës dëgjimore në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit N.V. mbrojtësja e tij sipas detyrës zyrtare avokate Emine Kaçiku, si dhe ekspertit neuropsikiatrik Dr. Sami Rexhepi, pas përfundimit të seancës dëgjimore e cila ka qenë e mbyllur për publikun, në mbështetje të nenit 513 dhe 514 të KPP-së si dhe nenit 85 par.2 dhe 86 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me datë 16.10.2024, e ka shpallur vendimin dhe të njëjtën ditë mori këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri:

N. V., nga i ati E..., e ëma E..., e gjinisë S..., i lindur me dt. ... , në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në lagjen Tjegullorja, me numër personal ... , i papunë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, të njëjtit përmes aktgjykimit P.nr.134/2021 të datës 26.08.2021, i ishte caktuar ndër tjera masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në ndalim dhe nga datë 26.08.2021 ka qenë duke u trajtuar në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë (IPFK).

-Në mbështetje të nenit 85 par 2 të KPRK-ës, ndaj të pandehurit N.V.:

- **PUSHOHET**- Masa- e Trajtimit te detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e kujdesit shëndetësor -Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, e cila masë ishte shqiptuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.134/2021, dt.26.08.2021 e i plotfuqishëm me dt.27.10.2021

Gjykata duke u bazuar në nenin 86 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të pandehurit N. V., i

SHQIPTON

- I. MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUAR PSIKIATRIK NË LIRI**, kjo masë do të ekzekutohet në Institucionin e kujdesit shëndetësor në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë.
- II.** I pandehuri N. V. obligohet që t'i nënshtrohet trajtimit të mëtejshëm psikiatrik dhe të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, menjëherë pas pranimit të këtij Aktvendimi, në mënyrë që të vazhdoj trajtimin sipas kohës, terminëve dhe rekomandimit të mjekëve, gjithashtu të përdorë terapinë sipas rekomandimit të ekspertëve të psikiatrisë.
- III.** Kohëzgjatja e masës do të bazohet në raportet dhe rekomandimet e ekspertëve të psikiatrisë pranë Qendrës së Shëndetit Mendor në Mitrovicë, por nuk mund të kalojë kohen me shume se tre (3) vjet.
- IV.** Institucioni i kujdesit shëndetësor-Qendra e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, obligohet që t'i dërgoi Gjykatës që ia ka shqiptuar masën raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit për të pandehurin E. B., se paku njëherë në gjashtë (6) muaj, dhe te njoftojë gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.
- V.** Në këtë rast mos respektimi i kësaj mase nga i pandehuri N.V., Gjykata mund të vendos për ndërrimin e masës - shqiptimin e masës se trajtimit të detyruar me ndalim.

- VI.** Kjo masë e trajtimit është caktuar/shqiptuar pasi që i pandehuri N. V., ende vuan nga problemet mendore: e cila kodohet me shifrën F-20.0 (ICD-10).
- VII.** I pandehuri N. V., lirohet menjëherë nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, pasi që ta pranoj këtë Aktvendim, me qëllim që të vazhdoi trajtimin e detyruar në liri pranë Qendrës së Shëndetit Mendor në Mitrovice.
- VIII.** I pandehuri lirohet nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve – paushallit gjyqësore dhe shpenzimeve të procedurës penale. Shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë do të mbulohen nga buxhetit i kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, sipas propozimit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.134/2021, dt.26.08.2021 e i plotfuqishëm me dt.27.10.2021 , ndaj të pandehurit N. V., ka shqiptuar masën Trajtim i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e kujdesit shëndetësor në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë (IPFK-ë). Këtë masë gjykata e ka shqiptuar pasi që ka konstatuar se i pandehuri veprën penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së, e ka kryer në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet raportit të dt.03.01.2024, i pranuar në gjykatë me dt.05.01.2024, e ka njoftuar gjykatën për gjendjen shëndetësore për të pandehurin N.V. ku i propozohet gjykatës që të njëjtit t'i ndërron masën e trajtimit me propozimin që ndaj tij të shqiptohet Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrike në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë.

Gjykata, në këtë çështje me dt.09.10.2024, ka mbajtur seancën dëgjimore sipas propozimit për ndryshimin e masës së trajtimit. Present në këtë seancë dëgjimore kane qenë: Prokurorit të Shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit N.V., mbrojtësja e tij sipas detyrës zyrtare avokate Emine Kaçiku, si dhe ekspertit neuropsikiatrik Dr. Sami Rexhepi.

Ne seancë dëgjimore është shqyrtuar propozimi i IPFK-së për ndërrimin e masës, është dëgjuar eksperti Dr. Sami Rexhepi nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë ku ishte duke u trajtuar i pandehuri, po ashtu janë dëgjuar gjitha palët rrethe këtij propozimi.

Eksperti i psikiatrisë Dr. Sami Rexhepi në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 09.10.2024, deklaroj se, ekzaminimi i klientit është bërë në IPFK, i cili ka qenë i shtrirë atje, gjatë ekzaminimit gjendja shëndetësore e tij ka qenë dukshëm e përmirësuar që d.m.th. se trajtimi i tij ne IPF i ka dhënë rezultate e veta. Tutje ka theksuar se është kërkuar edhe vlerësimi HCR i shkallës që për shkak të sëmundjes e cila ka një ecuri kronike dhe ka pas vepra të përsëritura ku pacienti ku tregon apo cilësohet me rrezikshmëri dhe mundësitë e përsëritjes së veprave penale. Gjithashtu ka deklaruar se qëndron mbas konkluzionit për ndërrimin e masës pasi gjendja është dukshme e përmirësuar, pasi që është sëmundje e cila është skizofreni paranoide që në klasifikimin ndërkombëtar kodohet me F20, jo shërim të plotë por me një trajtim adekuat, mund të arrihet një shkallë e kënaqshme e funksionalizimit të pacientit që mund të arrihet edhe nëse i njëjti gjendet në liri dhe të trajtohet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, dhe kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme të klientit dhe përdorimit të rregullt të barnave si dhe bashkëpunim me familjen dhe QSHM. Po ashtu besojmë se do të jetë gjendja shëndetësore më e mirë, nuk do të ketë acarime por vetëm mund të ndikoj mos marrja e terapisë, pasi që i njëjti merr terapinë nuk paraqet rrezik dhe është shumë funksional.

Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë, Shaqir Sedolli, mbrojtësja e të pandehurit N.V. av.Emine Kaqiku, si dhe i pandehuri N. V. janë pajtuar plotësisht me propozimin për pushimin e masës se trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe caktimit të masës se trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri për të pandehurin N. V.

Gjykata në bazë të mendimit të ekspertit ka vërtetuar se i pandehuri për momentin nuk paraqet ndonjë rrezik as për mjedisin të cilin e rrethon mirëpo duke marrë parasysh problemet mendore është e nevojshme dhe e domosdoshme të vazhdoj trajtimin me qëllim që të sigurohemi se i njëjti vazhdon ta marrë terapinë në mënyrë të rregullt dhe për këtë arsye është e nevojshme shqiptimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata, duke u bazuar në provat e lartcekura konstaton se tanimë Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ndaj të pandehurit N. V. nuk është e nevojshme, sepse i njëjti në një masë të madhe është trajtuar ne aspektin psikiatrik dhe ky trajtim ka dhënë rezultatet e tij,

se i pandehuri për momentin nuk paraqet ndonjë rrezik për veten e tij, apo për rrethin ku jeton, që nënkupton se rreziku i përsëritjes së veprave penale është minimal, mirëpo trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri edhe me tej është i nevojshëm dhe i domosdoshëm duke marrë parasysh problemet psikike, natyrën e sëmundjes nga e cila vuan i pandehuri, sëmundje e cila ka nevojë në trajtimin e vazhduar për të zvogëluar në minimum mundësin e rrezikut për përsëritjen e veprave penale, apo rrezikun që i pandehuri mund të paraqes për veten e tij dhe rrethin ku jeton.

Duke u bazuar në arsyet e cekura e në mbështetje të nenit 85 par.2 të KPRK-së, Gjykata ka vendos që ndaj të pandehurit të pushojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim e cila ishte shqiptuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.134/2021, dt.26.08.2021 e i plotfuqishëm me dt.27.10.2021, me arsyetimin se kjo masë nuk është e nevojshme të mbetet edhe me tej në fuqi, e duke konsideruar se janë plotësuar kushtet në tërësi për ndërrimin e kësaj mase dhe zëvendësimin me masën më të butë: -Trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri në Institucionin e kujdesit shëndetësor në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, ku i pandehuri N.V., duhet të paraqitet në këtë qendër sipas nevojës dhe rekomandimeve të mjekëve, duhet të marrë terapinë sipas përshkrimit të mjekëve, si dhe duhet të vazhdoi trajtimin psikiatrik derisa të ketë nevojë për këtë trajtim, për jo më gjatë se koha e përcaktuar me këtë Aktvendim.

Në rast se N. V., nuk e respekton masën e caktuar nga gjykata, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjykata mund të i caktoj masën e detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion dhe kujdesit shëndetësor.

Gjykata sipas këtij vendimi e obligon Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, që t'i ofrojë trajtim të nevojshëm psikiatrik në liri të pandehurit N. V. sipas nevojës se tij për trajtim, kushteve dhe terminëve të përcaktuara nga mjeku përgjegjës në këtë qendër. Në këtë drejtim obligohet ky institucion të njoftoj gjykatën për hapat që kanë ndërmarrë në ofrimin e trajtimit psikiatrik për N. V. si dhe për rezultatin e trajtimit dhe respektimin e kësaj mase.

Nga sa u tha me lart në mbështetje të nenit 85 par. 2 lidhur me nenin 86 par.1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe neneve 513 dhe 514 të Kodit të Procedurës Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.134/2021, datë 16.10.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese:
Marigona LAJQI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 8 ditëve nga dita kur palët e pranojnë Aktvendimin me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës se Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.